



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.840/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A...&A...-NNP E....., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat Vehbi Halili kundër të paditurës Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Arsim Zuka, për kompenzim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.606/19 e datës 02/09/2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 31/08/2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e paditëses A...&A...-NNP E....., me seli në Prishtinë **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.606/19 e datës 02/09/2021, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale Dhomës së Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar III.EK.nr.606/19 e datës 02/09/2021, në pikën I të dispozitivit ka vendosur të shpallet jo kompetente në çështjen juridike të paditëses A...&A...-NNP E....., me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër të paditurës Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa në pikën II është vendosur që pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me të gjitha shkresat, në afat prej tri ditëve, t'i dërgohet në kompetencë lëndore Gjykatës së Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditëses, me propozim që të aprovohet ankesa dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. E paditura nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se: Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja pranë gjykatës së shkallës së parë me datën 22/10/2019 ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që t'ia paguaj dëmin në

shumë prej 11,588.00 euro, nga data e përbushjes së kontratës e deri në përmbarimin e këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar është shpallur jo kompetente në çështjen juridike të kompenzimit të dëmit, duke u bazuar në nenin 17,19, 392 pika b) të LPK-së e lidhur me nenin 13 par.1.1 të Ligjit për Gjykatën , nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 22 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare me Nr. 06/L-016 dhe dhe bazuar në nenin 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1 i Ligjit për Gjykatat me Nr. 06/L – 054 duke konsideruar se nuk ka kompetencë lëndore të vendos këtë çështje juridike kontesitmore, me arsyetim se paditësja nuk e ka satusin e Shoqërisë Tregtare i cili është kusht ligjor, për të qenë palë në procedurën që zhvillohet në këtë departament të kësaj gjykate, për këto arsye te dhëna më lartë, Departamenti për Çështje Ekonomike i kësaj gjykate, nuk ka kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike kontestuese dhe mbi këtë bazë ka vendosur që lënda t’i kthehet në kompetencë lëndore të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 par.1 të LPK-së.

Pretendimet ankimore të paditëses, konsistojnë në atë se gjykata në shkallë të parë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale sepse gjykata duhet që sipas detyrës zyrtare, menjëherë pas marrjes së padisë të konstatoj se a është kompetente për procedimin e çështjes që i është paraqitur.

Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtoj pretendimet ankimore të paditëses dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, për shkak se me nenin 13 par 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale është përcaktuar kompetenca lëndore e Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë dhe Dhoma e Shkallës së Dytë si vijon: “Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka ardhur në përfundim se në këtë çështje juridike duhet të shpallët jo kompetente në pikëpamje lëndore, për shkak se nga referati i padisë rezulton se palët ndërgjyqëse janë shoqëri tregtare dhe me padi pretendohet se në mes tyre janë krijuar marrëdhënie juridiko-detyrimore me karakter afarist.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, par.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.840/22, data 31.08.2022

d.v

Kryetarja e kolegjit-Saranda Bogaj Sheremeti,